



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
DREJTORIA PËR ARSIM

09 Nr. 111/01-27509, dt. 07/06/2024



Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASHTI) nr.03/2022 , për përfshirjen e fëmijëve në Institucionet parashkollore në Kosovë si dhe në bazë të kapaciteteve infrastrukturore të institucionit parashkollor në QEAP “ Ardhmëria”, në Drenas , Komoran dhe Çikatovë e Re në Kosovë , DKA shpallë:

KONKURS

Për përfshirjen e fëmijëve në edukimin parashkollor në QEAP “ ARDHMËRIA ”, në Drenas, Çikatovë e Re dhe Komoran

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASHTI) nr.03/2022, për përfshirjen e fëmijëve në Institucionet parashkollore në Kosovë, për vitin shkollor 2024/2025 , për këtor vende të lira:

Në Drenas:

1. Grup mosha 9 muaj -1 vjeç----- 3 fëmijë,
2. Grup mosha 1-2 vjeç ----- 2 fëmijë,
3. Grup mosha 2-3 vjeç ----- 7 fëmijë.

Në Çikatovë e Re:

1. Grup mosha 3-4 vjeç ----- 5 fëmijë
2. Grup mosha 4-5 vjeç ----- 8 fëmijë

Në Komoran :

1. Grupi 3- 4 vjeç ----- 15 fëmijë,
2. Grupi 4 -5 vjeç ----- 15 fëmijë.

Kriteret për aplikimin dhe përfshirjen e fëmijëve në QEAP “ Ardhmëria “ janë të përcaktuara në Udhëzimin administrativ nr. 03/2022.

Përparsi: Kanë fëmijët që i kanë dy prindërit e punësuar.

Përfshirja:

Përfshirjen e fëmijëve në edukimin parashkollor në QEAP” Ardhmëria “ do të bëjë Komisioni i përzgjedhur nga Drejtoria për Arsimit në Drenas.

APLIKACIONI

Aplikacioni për përfshirjen e fëmijëve në këtë institucion merret në QEAP “ Ardhmëria “ në Drenas, të plotësohet rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe me shkronja të mëdha të shtypit.

Dokumentet duhet të kompletohen dhe të plotësohen në bazë të U.A .nr.03/2022 .

Konkursi mbetet i shpallur me afatin prej 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit,



Drejtori për Arsimit

Muhamet Gjoka